

PROCESVERBAL - Tipi i kontratës - PUNË

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS:

**“Rikonstrukcion Zyra Postare Qendër Korçë, Zyra Postare Qendër Pogradec”,
Kodi përkatës në fjalorin e përbashkët të prokurimit (FPP) : 45210000-2 Punime ndërtimi.**

VLERA E FONDIT LIMIT:

20,000,000 (njëzet milion) lekë pa TVSH.

Specialist i Fushës, në zbatim të urdhërit “Për krijimin e njësisë së prokurimit, hartimit të specifikimeve teknike, kriterëve të veçanta të kualifikimit dhe argumentimit të fondit limit”, për argumentimin e fondit limit j’u referua studimit të tregut, në mbështetje të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, nenit 76:

Në përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës, autoriteti/enti kontraktor duhet t’i referohet një ose më shumë alternativave të renditura, si më poshtë vijon:

a) çmimet e botuara nga Instituti i Statistikave (INSTAT), ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, në manuale etj.); ose/dhe

b) studimit të tregut, bazuar në mesataren e çmimeve të marra nga ky studim;
ose/dhe

c) çmimet e kontratave të mëparshme, të realizuara nga vetë apo nga autoritete të tjera kontraktore; ose/dhe

ç) çmimet ndërkombëtare të shpallura publikisht.

Autoriteti/enti kontraktor mund t’i referohet një ose më shumë alternativave të mësipërme në përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës, me qëllim që ajo të jetë një vlerë reale për kushtet e tregut dhe njëkohësisht të krijojë mundësinë e pjesëmarrjes së sa më shumë operatorëve ekonomikë.

2. Autoriteti/enti kontraktor, përpara nxjerrjes së urdhrit të prokurimit, duhet të argumentojë dhe të dokumentojë përlllogaritjen e vlerës së kontratës, bazuar në specifikimet teknike të objektit që prokurohet.

3. Për përlogaritjen e vlerës limit të kontratës, titullari i autoritetit/entit kontraktor mund të caktojë struktura të posaçme. Në rast se nuk ngrihen struktura të posaçme, kjo detyrë i ngarkohet specialistit të fushës ose njësisë së prokurimit.

Në përlogaritjen e vlerës së fondit limit të kontratës, Autoriteti ynë kontraktor, ka zbatuar parashikimet e Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publike”, neni 49 si dhe në nenin 55 të Kreut VI të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimeve Publike” i ndryshuar, kjo pasi ka zhvilluar procedurën e prokurimit me **REF- 85598-10-27-2023**, me objekt: “Hartimi i Projekteve të Zyrave Postare”.

Kohëzgjatja e kontratës do të jetë 5 (pesë) muaj kalendarike nga fillimi i punimeve.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, neni 2, pika 2/c dhe neni 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës 3;

b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit, sipas shtojcës 8

Shtojca 8. Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, neni 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Sipas kriterëve të përgjithshme të pranimit/kualifikimit (shtojca 7).

Argumentimi : Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, neni 39, pika 6/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet ekonomike dhe financiare, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2021, 2022 dhe 2023, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se 95% e vlerës së fondit limit të kontratës objekt prokurimi.**

Argumentimi : Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën **95% e fondit limit** të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë :

Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë :

- vlerën e parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar, bazuar në shkronjën “b”, të pikës 2, të nenit 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetimet që dëshmojnë se kanë paguar detyrimet përkatëse, të taksave dhe tarifave vendore, në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, në të gjitha vendet ku kanë ushtruar aktivitet sipas të dhënave të QKB-së, për vitin 2023 dhe detyrimet e maturuara për vitin 2024.

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit të BOE, duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Njësitë Administrative përkatëse ku ka ushtruar apo ushtron aktivitet për vitin 2023 dhe detyrimet e maturuara për vitin 2024, sipas të dhënave të QKB-së.

Shënim : Operatorët ekonomikë për përmbushjen e kësaj kërkesë duhet të vetëdeklarojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST, se kanë paguar detyrimet përkatëse, të taksave dhe tarifave vendore, në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, në të gjitha vendet ku kanë ushtruar aktivitet sipas të dhënave të QKB-së, për vitin 2023 dhe detyrimet e maturuara për vitin 2024.

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit paraprak dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar sipas Nenit 76 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”; Kreut V, Seksioni III, Nenin 43, pika 6 të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” si dhe sipas Ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” (i ndryshuar). Njësia e Prokurimit argumenton se pika 3 është vendosur në kuadër të Ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e Taksave Vendore” (i ndryshuar), Neni 5, gërma “c” ku citohet se: “...përcakton numrin e kësteve të pagimit të taksës

dhe afatet e kryerjes së tyre, si dhe kushtet lehtësuese në rastet e pagesës së plotë dhe përpara afateve të detyrimeve fiskale”.

2.3 Kapaciteti teknik :

2.3.1 Operatorët ekonomikë duhet të kenë përvojë të suksesshme në kontrata të mëparshme dhe për këtë duhet të paraqesin :

- a) dokumentacion për punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të ulët se 49% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës;
- b) dokumentacion për punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e ulët se 195% e vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Vlerësimi i përvojës së suksesshme të Operatorit Ekonomik do të kryhet bazuar në deklaratat e dokumentat e mëposhtme:

Për kontrata të realizuara me ente publike operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

- Formular vlerësimi për realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr. 9, shoqëruar me:
- Kontratë Sipërmarrje;
- Situacionin përfundimtar;
- Faturat tatimore;
- Aktin e kolaudimit;
- Certifikaten e marrjes në dorezim të perkohshëm/përfundimtar.

Shënim : *Formulari i vlerësimit duhet të përcaktojë saktësisht cilësinë e kryerjes së punëve, dhe faktin nëse kontrata është realizuar me sukses.*

Për kontrata të realizuara me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm :

- Kontrate Sipërmarrje;
- Situacionin përfundimtar;
- Faturat tatimore;
- Akt kolaudimi objekti.

- Për kontratat e realizuara si Bashkim Operatoresh, operatori ekonomik ofertues, krahas dokumentacionit të sipërcituar për secilin rast respektivisht, duhet të paraqesë edhe

Kontraten e bashkimit te operatoreve shoqeruar me tabelën e ndarjes së punimeve, ku te cilësohen punimet qe ka marrë përsiper të kryejë secili anëtar i BOE.

- Për kontratat e realizuara si Nënkontraktor, operatori ekonomik ofertues duhet te paraqesë: Kontratën baze ndermjet Kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor, si dhe miratimin zyrtar si nenkontraktor i deklaruar nga ana e autoritetit kontraktor.

Argumentimi : Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme të jenë minimalisht në vlerat punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 49% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet ose punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se 195% e vlerës se fondit limit të kontratës që prokurohet për punët totale të ngjashme të kryera në 5 vitet e fundit, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar.

- Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë :
-

- Për kontratat e realizuara si Bashkim Operatoresh, operatori ekonomik ofertues, është kërkuar edhe paraqitja e kontratës së bashkimit te operatoreve shoqeruar me tabelën e ndarjes së punimeve, ku te cilësohen punimet që ka marrë përsiper të kryejë secili anëtar i BOE, mbështetur në parashikimet e nenit 88 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar. Me anë të këtij dokumentacioni AK ka mundësi të njihet me vlerën reale të punimeve të realizuara nga ofertuesi/t, mbi bazën e një kontrate të realizuar si BOE.
- Për kontratat e realizuara si Nënkontraktor është kërkuar edhe miratimi nga ana e autoritetit kontraktor, si nënkontraktor i deklaruar, në respektim të parashikimeve të nenit 89 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar.

Pra, dokumentacioni i kërkuar si më sipër, është kërkuar me qëllim që AK të përlllogarisë vlerën e saktë të kontratave të mëparshme të realizuara nga ofertuesi, brenda afatit të përcaktuar në pikën 2.3.1, shkronja a) dhe b).

2.3.2/a Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, të lëshuar nga Ministria e Infrastruktures dhe Energjië, në bazë të VKM nr. 42 datë 16.01.2008, të ndryshuar, e cila përfshin kategoritë e mëposhtme :

Për punimet e përgjithshme të ndërtimit :

- NP -3 A. Rikonstrukcion dhe mirëmbajtje godinash civile e industriale, veshje fasada.

Për punimet speciale të ndërtimit :

- NS -1 A. Punime për prishjen e ndërtimeve
- N.S - 2 A Impiante hidrosanitare, kuzhina, lavanteri, mirëmbajtja e tyre;
- N.S - 4 A Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniture me materiale druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniture të natyrës teknike ndërtues;
- N.S - 12 A Impiante teknologjike, termike dhe të kondicionimit;
- N.S - 14 A Impiante të brendshme elektrike, telefonike, radiotelefoni TV.

Për operatorët e huaj të bëhet njehsimi i licencës profesionale që disponojnë nga vendi i origjinës pranë Institucionit përkatës, në plotësim të licencave profesionale të kërkuara për ekzekutimin e kontratës.

Argumentimi : Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/a, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, si dhe VKM nr. 42 datë 16.01.2008, të ndryshuar, “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi” (lidhja 2, 3 dhe 4).

Konkretisht :

Llojet e licencave dhe klasifikimi i tyre, sipas kategorive dhe niveleve (gërmave) përkatëse janë bërë në përputhje me natyrën e punimeve respektive dhe vlerën e përlllogaritur sipas preventivit të hartuar për këtë objekt.

Sipas VKM nr. 42 datë 16.01.2008, të ndryshuar, kategoria **N.P - 3 A** “Rikonstruksion dhe mirëmbajtje godinash civile e industriale, veshje fasadash.”:

Konsiderohen zgjidhjet dhe koordinimi i punimeve të specialiteteve të nevojshme për riaftësim, konservim, konsolidim, transformim, rivlerësim, ristrukturim. Konsiderohen gjithashtu dhe finitura të llojeve të ndryshme që lidhen me objektin, punime plotësuese dhe pajisje.

Sipas VKM nr. 42 datë 16.01.2008, të ndryshuar, kategoria **N.S – 1 A** “Punime për prishjen e ndërtimeve”: më sipër cituar *konsideron çmontimi i impianteve industriale dhe prishja komplet e ndërtesave me pajisje speciale ose me përdorim eksplozivi me prerje të strukturave betonarmeje dhe prishjeve në përgjithësi përfshi edhe grumbullimin e mbeturinave, ndarjen e tyre dhe riciklimin e materialeve.*

Sipas VKM nr. 42 datë 16.01.2008, të ndryshuar, kategoria **N.S - 2 A** “Impiante hidrosanitare, kuzhina, lavanteri, mirëmbajtja e tyre”:

Konsiderohet, montimi, mirëmbajtje ose ristrukturim i impianteve hidrosanitare të kuzhinës, lavanterisë së gazit dhe kundër zjarrit, sado që të jetë shkalla e rëndësisë së veprave, e kompletuar

me punimet e muraturës plotësuese ose ndihmëse, që janë realizuar ose janë duke u realizuar në punimet e përgjithëshme.

Sipas VKM nr. 42 datë 16.01.2008, të ndryshuar, kategoria **N.S - 4 A** “Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniture me materiale druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniture të natyrës teknike ndërtuese”:

Konsiderohet ndërtimi, mirëmbajtje ose ristrukturim i muraturës dhe mureve ndarës të çfarëdo lloji, tipi, përfshirë suvatimin, patinimin, bojatisjen dhe punime të ngjashme me to.

Konsiderohet vendosja në vepër, mirëmbajtja dhe ristrukturimi i karpenterisë dhe punimeve prej druri, të dyerve dhe dritareve të brendshme dhe të jashtme, të veshjeve të brendshme dhe të jashtme të dysHEMEVE të tipeve të ndryshme dhe me materiale të ndryshme dhe të punimeve të realizuara me dorë, me metal, dru, material plastik dhe material xhami ose të ngjashëm.

Konsiderohet vendosja në vepër, mirëmbajtja dhe ristrukturimi i izolimit termik dhe akustik, nënçatitë dhe mbrojtja nga zjarri, izolimi i natyrave të ndryshme dhe me materiale të ndryshme.

Sipas VKM nr. 42 datë 16.01.2008, të ndryshuar, kategoria **N.S - 12 A** “Impiante teknologjik, termike dhe të kondicionimit”:

Konsiderohen montimi dhe mirëmbajtje ose ristrukturimi i një sistemi të plotë, sido që të jetë shkalla e rëndësisë së tyre, të ngrohjes, ventilimit dhe kondicionimit të klimës, të impianteve pneumatike, të kompletuara me punimet murature, plotësuese ose ndihmëse, për të realizuar bashkimet ose ndërhyrjet që i përkasin kategorive të përgjithshme që janë realizuar ose janë në proces realizimi.

Sipas VKM nr. 42 datë 16.01.2008, të ndryshuar, kategoria **N.S - 14 A** “Impiante të brendshme elektrike, telefonike, radiotelefoni TV”.

Konsiderohet montimi, mirëmbajtja dhe ristrukturimi i linjave elektrike, telefonike, radiotelefoni e TV, si edhe të linjave të trasmetimit të ngjashme me to, të kompletuar me çdo punim të lidhur me muraturën, plotësuese ose ndihmëse, për t’u realizuar, të ndara nga zbatimi i sistemeve të tjera që janë realizuar ose janë duke u realizuar në punimet e përgjithshme.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 42, datë 16.01.2008, "Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi", i ndryshuar.

Përcaktimi i kategorisë së licencave bazohet në kriteret të përcaktuara ligjore e teknike. Të dhënat për licencat e mësipërme janë vendosur referuar bazës ligjore për ndërtimet, ligjit nr. 8402 datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” të ndryshuar, neni 8 përcakton

"Zbatimi i punimeve të ndërtimit kryhet vetëm nga persona juridikë, privatë ose publikë, vendas ose të huaj, të pajisur me licencën përkatëse, për zbatim punimesh ndërtimore. Zbatuesi i punimeve mban përgjegjësi dhe është i detyruar të realizojë punimet e ndërtimit, në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të zbatimit dhe rregullat e sigurimit teknik. Ai duhet të sigurojë cilësinë e materialeve të ndërtimit dhe produkteve të ndërtimit, të cilat duhet të plotësojnë kërkesat e projektit në përputhje me standartet kombëtare ose europiane." Lidhur me nivelin e kategorive në licencë janë në përputhje me natyrën dhe fondin limit që prokurohet, si dhe kërkohet që operatorët ekonomik të japin garanci që i kanë aftësitë tekniko profesionale ne nivele të kategorive për realizimin e objektit që prokurohet.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente kompetente.

Licencat janë të lidhura ngushtësisht me zërat e punimeve të ndërtimit. Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret, që autoriteti i vlerëson të nevojshme, për sa kohë ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës.

Kategoritë e kërkuara janë kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve, si më poshtë:

NR	Kategoria e kërkuar	Pershkrimi i kategorisë sipas legjislacionit të fushës	Zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse	Niveli i klasifikimit i kërkuar për kategorinë respektive	Vlera e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse
1	NP -3	Rikonstruksion dhe mirëmbajtje godinash civile e industriale, veshje fasada.	Punimet sipas preventivit të zyres postare Pogradec , Kapitulli II Punime shtresash , Kapitulli III Punime shtresash dhe izolimesh në tarace , Kapitulli IV Punime Ndertimi , Punimet sipas preventivit të zyres postare Pogradec , Kapitulli II Punime shtresash ,Kapitulli III Punime Ndertimi	Niveli A	7442176 leke pa tvsh
2	NS -1	Punime për prishjen e ndërtimeve	Punimet sipas preventivit të zyres postare Pogradec dhe Korçe , Kapitulli I Punime Prishje	Niveli A	928737 leke pa tvsh
3	N.S - 2	Impiante hidrosanitare, kuzhina, lavanteri, mirëmbajtja e tyre;	Punimet sipas preventivit të zyres postare Pogradec dhe Korçe , Kapitulli V Punime Hidraulike dhe Hidrosanitare ,	Niveli A	203003 leke pa tvsh
4	N.S - 4	Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniture me materiale druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniture të natyrës teknike ndërtues;	Ne preventiv zeri nr (5-6)Kap 3, Punime Bojatisje	Niveli A	649620 leke pa tvsh
5	N.S-12	Impiante teknologjike, termike dhe të kondicionimit;	Punimet sipas preventivit të zyres postare Pogradec dhe Korçe , Kapitulli VII Punime kondicionimi Aspirimi	Niveli A	5871685 leke pa tvsh

6	N.S -14	Impiante të brendshme elektrike, telefonike, radiotelefoni TV.	Punimet sipas preventivit të zyrës postare Pogradec dhe Korçe , Kapitulli VI Punime Elektrike	Niveli A	3193247 leke pa tvsh
---	---------	--	---	----------	-------------------------

2.3.2/b Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të jenë të pajisur me license leshuar nga QKL, “Kodi III.2.B” (Për grumbullim, ruajtje dhe transport të mbetjeve inerte dhe të ngurta), së bashku me aktin e miratimit, në përputhje me parashikimet e vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 538, datë 26.5.2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”, i ndryshuar.

Argumentimi : Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 39, pika 6/a, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, si dhe në nenin 4, pika e 1/b e ligjit nr. 10448, datë 14.7.2011 “Për lejet e mjedisit” i ndryshuar, ku parashikohet se: “*leja e mjedisit e tipit B është e detyrueshme për kryerjen e veprimtarive të kategorisë B, lista dhe pragjet përkatëse të të cilave janë përcaktuar në shtojcën 1/B të këtij ligji*”.

Në shtojcën 1/B është listuar edhe veprimtaria “Menaxhimi i mbetjeve”.

Në nenin 57/2 të ligjit nr. 10463, datë 22.9.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, i ndryshuar, parashikohet se: “Qendra Kombëtare e Licencimit lëshon licencën **për transportin e mbetjeve**, e cila përfshihet në nënkategorinë III.2.B të fushës III të vendimit nr. 538, datë 26.5.2009 të Këshillit të Ministrave “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga/apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”, pas miratimit të saj nga ministri”.

Ndërkohë, sipas VKM nr. 538, datë 26.5.2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet qendrës kombëtare të licencimit (qkl) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”: “Veprimtaria e nënkategorisë III.2.B specifikohet në veprimtari të tilla si grumbullim, transportim, ruajtje, riciklim, përpunim apo asgjësim i mbetjeve të llojeve të ndryshme”.

Kjo kategori licence i referohet zërave të punimeve të parashikuara në preventivin e punimeve objekt prokurimi.

2.3.3 **Dëshmi për fuqinë punëtore të operatorit ekonomik:**

a) Operatorët ekonomikë pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojnë personelin kryesor, drejtues teknik në licencën e shoqërisë, si më poshtë :

- | | |
|-------------------------|---------|
| - Inxhinier Ndërtimi | 2 (dy) |
| - Inxhinier Mekanik | 1 (një) |
| - Inxhinier Hidroteknik | 1 (një) |
| - Inxhinier Elektrik | 1 (një) |
| - Inxhinier Elektronik | 1 (një) |
| - Arkitekt | 1 (një) |

Për këtë operatorët ekonomikë duhet të paraqesin :

- Kontratë pune, Diplomën Universitare, Libreze pune dhe Cv.
Drejtuesit teknik duhet të jenë të punësuar sipas kriterëve të VKM nr. 42 datë 16.01.2008, i ndryshuar, sa i takon ndalimeve të dypunësimit.
Në çdo rast, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të bëjë verifikime lidhur me deklarinimin e OE, në funksion të përmbushjes së këtij kriteri.

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST.

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit paraprak dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

b) Operatorët ekonomikë duhet të disponojnë punonjës të specializuar/të kualifikuar, si më poshtë :

- | | |
|--|-----------|
| - Teknik Ndërtimi | 2 (dy) |
| - Teknikë/Specialistë të inxhinierisë elektronike dhe/ose të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit | 2 (dy) |
| - Hidraulikë | 3 (tre) |
| - Elektricistë | 3 (tre) |
| - Instalues dhe riparues të kondicionerëve dhe sistemeve ftohëse-ngrohëse | 3 (tre) |
| - Hidroizolues | 3 (tre) |
| - Specialist gipsi | 4 (katër) |
| - Bojaxhi | 3 (tre) |
| - Shtrues pllakash dhe të tjerë që lidhen me to | 4 (katër) |
| - Murator – Suvatues | 3 (tre) |

Për punonjësit e mësipërm duhet të paraqitet:

- Kontratë pune e vlefshme,

- Diplomë/certifikate profesionale lëshuar nga institucione publike/private të licencuara sipas ligjit Nr.15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë ose ekuivalente

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST. Në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, Deklarata B, operatorët ekonomik duhet të deklarojnë për punonjesit e mesiperm, emer/mbiemer, profili i punës, numri dhe datë e kontratës individuale të punës, numri amzes dhe titulli i kualifikimit për diplomën përkatëse, si dhe institucionin që ka lëshuar këtë dokument. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit paraprak dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

Argumentimi : Kërkesat e shkronjave a) dhe b), të pikës 2.3.3, të kriterëve të veçanta për kualifikim, janë bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/c), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, të ligjit nr. 15/2017 “Per arsimin dhe formimin profesional në R.Sh.” dhe VKM nr. 514, datë 20.9.2017 “Për miratimin e listës kombëtare të profesioneve (LKP)”, të rishikuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Personeli i mësipërm kërkohet në bazë të vlerësimit të preventivit dhe të grafikut të punimeve.

- **Inxhinieri i Ndërtimit** është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve të objektit që do të ndërtohet për të gjithë zërat e punimeve ndërtimore, sipas parashikimeve në projektin konstruktiv janë kërkuar 2 inxhinier ndërtimit për faktin që janë në rikonstrukcion dy objekte në qytete të ndryshme dhe është i nevojshëm që inxhinieri të jete gjatë gjith kohës ipranishëm në objekt
- **Inxhinieri Mekanik** është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve mekanike, referuar punimeve të parashikuara në preventiv (Punime mekanike), sipas parashikimeve në projektin mekanik (HVAC).
- **Inxhinieri Hidroteknik** është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve hidraulike lidhur me zërat e punimeve të parashikuara në preventiv Punime Hidraulike, sipas parashikimeve në projektin hidroteknik.
- **Inxhinieri Elektrik** është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve të objektit që do të ndërtohet për secilin nga zërat e punimeve elektrike, konkretisht zërave të punimeve të parashikuara në preventiv Punime Elektrike, rubrikat me emërtesë “Instalime Elektrike”, “Celesa, Priza”, “Percjellesa dhe Kabllo” dhe “Tubo, kuti shperndarese, kanalina”, etj.
- **Inxhinieri Elektronik** është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve të objektit që do të ndërtohet për secilin nga zërat e punimeve elektronike, konkretisht zërave të punimeve të parashikuara në Punime Elektrike, rubrikat me emërtesë, “Sistemi i Prizave LAN dhe Telefoni”, etj.

- **Arkitekti** është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve të ndryshme të objektit që do të ndërtohet, sipas parashikimeve të projektit arkitektonik, relacionit dhe specifikimeve teknike arkitektonike.
 - **Tekniku i ndërtimit** është i nevojshëm për ndjekjen e realizimit të punimeve të ndërtimit, sipas zërave të preventivit të punimeve
 - **Teknikë/Specialistë të inxhinierisë elektronike dhe/ose të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit** është i nevojshëm për montimin dhe operimin e pajisjeve elektronike apo komponentëve të tyre, nën mbikëqyrjen e inxhinierëve.
 - **Hidrauliku** është i nevojshëm për ndjekjen dhe realizimin e punimeve hidraulike, sipas zërave të preventivit të punimeve.
 - **Elektriçisti** është i nevojshëm për ndjekjen dhe realizimin e punimeve elektrike, sipas zërave të preventivit të punimeve.
 - **Instalues dhe riparues të kondicionerëve dhe sistemeve ftohëse-ngrohëse** është i nevojshëm për ndjekjen dhe realizimin e punimeve të kondicionimit dhe aspirimit, sipas zërave të preventivit të punimeve.
 - **Hidroizoluesi** është i nevojshëm për realizimin e punimeve të termo-izolimit me materialin e duhur sipas zërave të preventivit të punimeve.
 - **Specialist gipsi** është i nevojshëm për realizimin e mureve dhe tavaneve me gips, sipas zërave të preventivit të punimeve.
 - **Bojaxhiu** është i nevojshëm për realizimin e punimeve të lyerjes, sipas zërave të preventivit.
 - **Shtrues pllakash dhe të tjerë që lidhen me to** është i nevojshëm për realizimin e punimeve të shtrimit të pllakave, sipas zërave të preventivit.
 - **Murator – Suvatues** është i nevojshëm për realizimin e punimeve të suvatime dhe muratur tulle , referuar zërave të preventivit të punimeve.
- c) Operatorët ekonomikë duhet të përcaktojnë me anë të një deklarate nga (Administratori i shoqërisë), Përgjegjës Teknik të Kantierit, i cili do të sigurojë drejtimin teknik të punimeve në kantier dhe nuk duhet të jetë i angazhuar në kontrata të tjera. Përgjegjësi Teknik i Kantierit, i deklaruar duhet të plotësojë kriteret e përcaktuara në Udhëzimin nr. 2, datë 13.5.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”.

Argumentimi : Kërkesat e shkronjës d), të pikës 2.3.3, të kriterëve të veçanta për kualifikim janë është bazuar në Kreun I/2.1 të Udhëzimit nr. 2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit“, përcaktohet se “Drejtimi teknik i punimeve në kantier sigurohet, sipas rastit, drejtpërdrejt nga drejtuesi teknik i sipërmarrësit ose përgjegjësi teknik i kantierit. Për vepra me vlerë të plotë, të preventuar mbi 30 000 000 (tridhjetë milionë) lekë, përgjegjësi teknik i kantierit është rezident, me kohë pune të plotë në objekt dhe i diplomuar në inxhinieri ndërtimi”.

- d) Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se kanë të punësuar në stafin e tyre 1 (një) punonjës i cili të plotësojë kërkesat dhe të disponojë çertifikatën si “Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë”, në përputhje me klauzolat e Ligjit Nr. 10237 datë 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M Nr. 312, datë 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier".

Për këtë operatorët ekonomikë duhet të paraqesin :

- kontratën e punës,
- diplomën/certifikatën përkatëse.

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST.

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit paraprak dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

Argumentimi : Kërkesa e shkronjës e) të pikës 2.3.3, të kriterëve të veçanta për kualifikim, është bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 39, pika 6/c), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht:

Kërkesa e mësipërme mbështetet në ligjin nr. 10327 datë 18/02/2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe V.K.M nr. 312, datë 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier”. Natyra e kontratës dhe specifikat e saj kërkojnë njohuri e përgatitje të posaçme për vlerësime të përpikta për të zgjidhur çështje që lidhen me garantimin e sigurisë dhe mbrojtjen në punë. Në rregulloren për sigurinë në kantier miratuar me VKM nr. 312/2010 është përcaktuar se punëdhënësi për mbrojtjen dhe parandalimin nga rreziqet, duhet të ofrojë kurse formimi përkatës në fushën e sigurisë e të shëndetit në vendin e punës. Çdo punëdhënës zgjedh një ose disa persona si përgjegjës për ndihmë e parë në rast emergjencash dhe për sigurinë e mbrojtjen e shëndetit. Rregullorja përcakton kërkesat minimale të sigurisë dhe të shëndetit në punë për kantieret e përkohshëm ose të lëvizshëm, si dhe masat e përgjithshme të mbikëqyrjes.

- e) Operatorët ekonomikë duhet të kenë të punësuar në stafin e tyre 1 (një) ekspert zjarrfikës të shoqëruar me certifikatë/dëshmi kualifikimi për ushtrimin e profesionit lëshuar nga PMNZH.

Për këtë operatorët ekonomikë duhet të paraqesin :

- kontratën individuale të punës;
- certifikatë/dëshmi kualifikimi.

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST.

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit paraprak dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

Argumentimi : Kërkesa e shkronjës i), të pikës 2.3.3, të kriterëve të veçanta për kualifikim është bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/c), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar dhe ligjit nr. 152/2015 “Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar referuar natyrës që parashikon projekti me qëllim realizimin me sukses të kontratës objekt prokurimi. Kjo kërkesë është vendosur referuar kërkesave të parashikuara në projektin e mbrojtjes ndaj zjarrit dhe relacionit teknik të tij, bashkëlidhur DT-ve.

Të gjithë punonjësit e kërkuar sipas pikës 2.3.3 (a dhe b), duhet të jenë në listpagesat e shoqërisë sipas profesioneve respektive, për periudhën jo më pak se 3 (tre) muajt e fundit të maturuara nga data e hapjes së tenderit.

Ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, duhet të dorëzojë pranë autoritetit kontraktor përpara publikimit të njoftimit të fituesit paraprak dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK, dokumentacionin si më poshtë :

- Listëpagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën jo më pak se 3 (tre) muajt e fundit të maturuara nga data e hapjes së tenderit..

Argumentimi : Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/ç), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, si dhe referuar grafikut të punimeve të hartuar nga Universiteti Politeknik i Tiranës. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtore si dhe përvojën e nevojshme për ekzekutimin e kontratës objekt prokurimit.

2.3.4 Operatorët ekonomikë duhet të disponojnë mjetet dhe pajisjet e nevojshme teknike për realizimin e kontratës :

Nr.	Mjete/pajisje teknike	Sasia	Gjendja
1.	Kamionçinë me kapacitet mbajtës deri në 3.5 ton deri ne 5 ton	2 copë	Në pronësi ose me qera
2.	Minifadrome MT	2 copë	Në pronësi ose me qera
3.	Autobetonjere kantjeri 2 deri ne 2.5 m3 MT	2 copë	Në pronësi ose me qera
4.	Betoniere	2 copë	Në pronësi ose me qera

5.	Depozite uji 5000 litra	2 copë	Në pronësi ose me qera
6.	Nivelues betoni i llojit helikopter	1 copë	Në pronësi ose me qera
7.	Matrapik	2 copë	Në pronësi ose me qera
8.	Trapan	2 copë	Në pronësi ose me qera

Ofertuesi për makineritë, të cilat janë në pronësi ose me qera, duhet të paraqesë, dokumentacionin e mëposhtëm :

Për mjetet që janë në pronësi, duhet të paraqitet :

- a) dokumenti që vërteton pronësinë (çertifikatën e pronësisë së mjetit rrugor);
- b) dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi);
- c) çertifikata e vlefshme e kontrollit teknik (SGS);
- d) siguracioni (polica e sigurimit) i vlefshëm i mjetit;
- e) leje transporti nga njësia vendore (sipas rastit);
- f) foto të mjetit ku të evidentohen qartësisht të dhënat specifike të tij.

Kur janë me qera, duhet të paraqitet :

- a) kontrata e qerasë;
- b) dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi);
- c) çertifikata e vlefshme e kontrollit teknik (SGS);
- d) siguracioni (polica e sigurimit) i vlefshëm i mjetit;
- e) leje transporti nga njësia vendore (sipas rastit);
- f) foto të mjetit ku të evidentohen qartësisht të dhënat specifike të tij.

Për mjetet apo pajisjet e tjera që nuk pajisen me leje qarkullimi, ofertuesi duhet të paraqesë kontratë noteriale të blerjes ose fatura tatimore të blerjes ose dokument zhdoganimit të mjetit dhe foto të tyre.

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST.

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit paraprak dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

Argumentimi : Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën. Mjetet dhe pajisjet e kërkuara janë vendosur në proporcion me zërat dhe volumet e punimeve dhe afatin e përllogaritur për realizimin e kontratës objekt prokurimi.

Numri dhe lloji i makinerive, paisjeve në pronesi / qira janë vlerësuar si të nevojshme në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës, duke i'u referuar punimeve sipas standardeve, grafikut, kohëzgjatjes së punimeve dhe specifikimeve teknike të projekt zbatimit. Për të zbatuar kontratën, operatorët ekonomikë duhet të përmbushin kapacitetet teknike të pajisjeve dhe aseteve të tjera fizike, për këtë janë përcaktuar edhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin ofertuesit. Nëpërmjet kapaciteteve teknike operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë aftësinë dhe kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative. Pajisjet dhe mjetet e mësipërme janë të lidhura ngushtë me objektin e kontratës dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve dhe të mundësisë së operatorit për përmbushjen me sukses të kontratës si dëshmi për mjetet dhe pajisjet sipas specifikave.

- 2.3.5 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë deklaratë furnizimi nga prodhuesi/distributori të autorizuar, për këtë procedurë prokurimi (Objekt, Nr.REF), ose autorizim prodhuesi/distributori zyrtar për materialet (Paisje hidrosanitare , Paisje Elektrike , Paisje për sistemin ftohëse-ngrohëse , Paisje për sistemin Lan , Paisje për sistemi e dedektimit të zjarrit , pllaka porcelanati , gips , stuko Patinimi dhe boje). Në rast paraqitje deklaratë furnizimi/autorizim distributori, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë një akt marrëveshje midis prodhuesit dhe distributorit e vlefshme midis tyre. Deklarata e furnizimit/autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, website, kjo e nevojshme për autoritetin kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.

Argumentimi: Në bazë të nenit 77 pika 4, të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 6, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Vendosja e këtij kriteri, referuar edhe legjislacionit në fuqi i shërben autoritetit kontraktor për të vlerësuar nëse një operator ekonomik ka kapacitete për të ofruar produktin e kërkuar si dhe për të verifikuar përmbushjen e specifikimeve teknike të mallrave të cilat janë të domosdoshme në realizimin e punimeve objekt prokurimi. Në këtë rast është shumë e rëndësishme plotësimi i specifikimeve teknike të kërkuara nga autoriteti kontraktor pasi kemi të bëjmë me produkte të cilat domosdoshmërisht duhet të garantojnë cilësinë e kërkuar dhe funksionalitetin gjatë përdorimit të tyre në kryerjen e punimeve të ndryshme specifike pasi përdoren në objekte arsimore ku kërkesat e cilësisë dhe të ruajtjes së mjedisit janë të larta.

- 2.3.6 Në mënyrë që të krahasohet pajtueshmëria me specifikimet teknike dhe standardet e kërkuara, ofertuesi duhet të paraqesë: kataloget ose skedat teknike ku të tregohen dhe të specifikohen qartë materialet që do të ofrohen dhe të jenë paraqitur dhe

markuar të dhënat teknike si dhe te paraqiten çertifikatë CE ose raportet e testimit nga laboratorë të akredituar (vendase ose te huaja) me qëllim përmbushjen e standarteve të kërkuara.

Argumentimi: Në bazë të nenit të 77, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 6/ c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” dhe Ligji nr.9779, datë 16.07.2007 “Për sigurinë e përgjithshme, kërkesat thelbësore dhe vlerësimin e konformitetit të produkteve joushqimore”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të paraqesin dëshmi të testimeve zyrtare të cilat provojnë përmbushjen e karakteristikave teknike të mallrave objekt të prokurimit. Prandaj autoriteti kontaktor e gjykon se këto produkte duhen të jenë të çertifikuara nga organizma çertifikues të akredituar.

2.3.7 Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se e zhvillojnë aktivitetin e tij në fushën objekt prokurimi në përputhje me standardet e menaxhimit të cilësisë, të shëndetit e sigurisë në punë dhe të mjedisit. Për këtë duhet të paraqesin certifikatat e mëposhtme :

- Sistemi i menaxhimit te cilesise (ISO 9001 – 2015 ose Ekuivalent) e vlefshme,

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a), nenin 79 të LPP, nenit 44 të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, është kërkuar kjo certifikatë me qëllim që operatorët ekonomikë që do të zbatojnë kontratën të jenë certifikuar në sistemin e menaxhimit të cilësisë. Çertifikata duhet të jetë e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Nisur nga rëndësia, volumi i kontratës, rëndësia e AK (Autoritetit kontraktor) të përfshirë në këtë procedurë është e rëndësishme me qëllim realizimin me sukses të kësaj procedurë që operatori pjesëmarrës të provojnë se ka një sistem të menaxhimit të cilësisë, pra të demonstrojnë aftësinë e tij për të ofruar vazhdimisht shërbime që plotësojnë kërkesat e konsumatorëve pra të AK-së dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullative me qëllim të rrisë kënaqësinë e konsumatorit nëpërmjet zbatimit efektiv të sistemit, duke përfshirë proceset për përmirësimin e vazhdueshëm të sistemit dhe sigurimin e konformitetit ndaj klientit pra Ak-së.

- Sistemi i menaxhimit te mjedisit (ISO 14001 – 2015 ose Ekuivalent) e vlefshme,

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a), nenin 79 pika 2 c) të LPP, nenit 44 të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”,

Ligjit nr.27/2017 datë 17.03.2016 “Për menaxhimin e kimikateve”, Ligjin nr.10216 datë 21.01.2010 “Për detergjentët”. Kjo certifikatë është kërkuar me qëllim që operatorët ekonomikë që do të zbatojnë kontratën të jenë certifikuar në sistemin e menaxhimit të mjedisit. Kuadri ligjor që rregullon tregtimin dhe përdorimin e produkteve detergjentë i kushton një rëndësi parësore mbrojtjes së mjedisit për vetë natyrën e rrezikshmërisë që mbartin këto produkte objekt prokurimi. Ky certifikim ofron një kuadër praktik për shoqëritë që menaxhojnë rreziqet mjedisore ekzistuese dhe potenciale në përputhje me parashikimet ligjore në fuqi. Certifikimi i operatorëve ekonomikë ofertues me Certifikatën ISO 14001 ose ekuivalente, lidhur me sistemin e menaxhimit të mjedisit garanton autoritetin kontraktor për sigurinë e trajtimit të produkteve detergjentë në të gjithë zinxhirin e furnizimit nga burimi i furnizimit deri në destinacionin e kërkuar.

- Sistemi i menaxhimit të shëndetit dhe sigurimit në punë ISO 45001-2018 ose Ekuivalent të vlefshme

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a), nenin 79 të LPP, nenit 44 të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, është kërkuar kjo certifikatë me qëllim që operatorët ekonomikë që do të zbatojnë kontratën të jenë certifikuar në sistemin e shëndetit dhe sigurisë në punë. Certifikata duhet të jetë e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. është kërkuar kjo certifikatë pasi ofron një kuadër për menaxhimin efikas të shëndetit dhe sigurisë në punë përfshirë gjithë aspektet e menaxhimit të riskut dhe të përputhshmërisë ligjore nga operatorë ekonomikë, të cilët do të ekzekutojnë këto kontrata shërbimi. Një OE i certifikuar sipas këtij standardi është në gjendje të:

- Krijojë kushtet më të mira të punës në gjithë organizatën e tij;
- Identifikojë kërcënimet dhe vendos kontrollin për menaxhimin e tyre;
- Redukton aksidentet dhe sëmundjet në vendin e punës duke minimizuar kostot dhe kohën
- Joproductive;
- Përfshin dhe motivon stafin me kushte më të mira dhe më të sigurt punë;
- Dëshmon përputhshmëri ndaj klientëve dhe furnitorëve;
- Të gjitha këto janë garanci se OE i shpallur fitues i cili është i certifikuar sipas këtij standardi ka kapacitetet e duhura për realizuar me sukses kontratat me AK-të. Certifikata të jetë e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Certifikatat si më sipër duhet të paraqiten origjinale ose kopje të noterizuara, të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Certifikatat duhet të jenë të vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a), nenin 79 pika 2 c) të LPP, nenit 44 të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik". Ky kriter është vendosur në përmbushje të detyrimeve ligjore që përcaktojnë Ligji nr.116/2014, datë 11.09.2014 "Për akreditimin e organeve të vlerësimit të Konformitetit", Ligji nr.10489 datë 15.12.2011 "Për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore", VKM nr.667, datë 29.07.2015 "Për organizimin dhe funksionimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit". Çertifikatat e lëshuara nga ente certifikuese të pa akredituara nuk garantojnë efikasitetin dhe sigurinë për kërkesat e cilësisë të cilat autoriteti kontraktor i kërkon për realizimin e kontratës.

Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë certifikatat ISO të kërkuara janë të detyrueshme për secilin operator ekonomik, sipas zërave të punimeve/shërbimeve/mallit që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike janë hartuar nga Projektuesi, i cili ka qënë përgjegjës për hartimin e specifikimeve të teknike në përputhje me ligjin Nr.162/2020 "Për Prokurimin Publik", si dhe VKM Nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar.

Specifikimet teknike gjenden në shtojcën e emërtuar specifikimet teknike.

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për shërbimet objekt prokurimi, që do të përfshihen në termat e referencës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 41, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët "ose ekuivalenti i tij/saj".***

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët "ose ekuivalente".

Njësia e Prokurimit